



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2020:920204  
Datë: 12.11.2024  
Numri i dokumentit: 06436872

**K.Dh.Sh.II.nr.1327/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “Arda Rei” shpk me seli në Prishtinë, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Palushi avokat ne Prishtinë, kundër te paditurës Komuna e Prishtinës, për shkak te propozimit për kthim ne gjendje te mëparshme, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.1754/22 e datës 23.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **11.11.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e paditëses Arda Rei shpk me seli në Prishtine dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.1754/22 e datës 23.04.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KE.nr.1754/22 e datës 23.04.2024, ka vendosur më sa vijon:

I. **HIDHET** poshtë si i pa afatshëm propozimi për kthim ne gjendje te mëparshme i datës 26.03.2024, i paraqitur nga paditësi “Arda Rei” shpk.me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala paditëse për shkak të shkeljes se dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të prishet aktvendimi dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo te ndryshoje aktvendimin e atakuar dhe te aprovoje propozimin e paditësit për kthim ne gjendje te mëparshme.

Pala e paditur nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**- Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën kontestimore të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë paditesi ka qenë i thirrur me rregull për në seancën e datës 20.02.2024, por nuk ka marrë pjesë në të dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka marrë aktvendimin KE.nr..1754/22 te datës 29.02.2024, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e palës paditëse.

I autorizuari i paditësit, më 26.03.2024, ka parashtruar në gjykatë propozim për kthim në gjendje të mëparshme, me arsyetimin se nuk ka mundur të marrë pjesë në seancë, duke qene se i autorizuari i paditësit ka qene ne pamundësi objektive, pasi qe ndodhej për mjekim qe nga data 19.02.2024 (dita kur ka pësuar lëndimin), e qe vërtetohet nga raportet mjekësore, si raporti mjekësorë i Klinikës e Radiologjisë – QKUK dhe raporti mjekësor i Spitalit Royal Medical.

Gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në nenin 130 par. 3 dhe nenin 133 par. 1 të LPK dhe nenin 509 pika b te LPK-se, me aktvendimin e goditur me ankesë e ka hedhur poshtë, si të paraqitur pas afatit, propozimin e paditësit për kthim në gjendje të mëparshme, me arsyetimin se nga data e mbajtjes së seancës (20.02.2024), deri në paraqitjen e propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme (26.03.2024), kanë kaluar më tepër se 15 ditë.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i paditesit ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që propozimi për kthim në gjendje të mëparshme të aprovohet, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim dhe rivendosje ose ai të ndryshohet dhe të lejohet kthimi ne gjendje te mëparshme.

Gjykata e shkalles se dytë, gjeti se ankesa e paditësit është e pabazuar, ndërsa aprovoi në tërësi, si të rregullt dhe të ligjshëm, vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, ngaqë është nxjerrë në përputhje me dispozitat e nenit 130 par. 2 dhe 3, nenit 131, nenit 133 par. 1 dhe nenit 509 pika b) të LPK. Neni 130 par. 2 përcakton afatin subjektiv të paraqitjes së propozimit për kthim në gjendje të mëparshme dhe ky afat është shtatë ditë, llogaritur nga dita e pushimit të shkakut të mosveprimit apo nga dita kur u mësuar për mosveprimin. Megjithatë, dispozita e nenit 509 pika b) të LPK përcakton afatin objektiv të paraqitjes së propozimit. Sipas kësaj dispozite, afati objektiv 15-ditor fillon dhe mbaron pavarësisht nga elementi subjektiv i propozuesit. Për këtë afat është i parëndësishëm momenti kur propozuesi ishte në dijeni ose do të duhej të ishte në dijeni për caktimin e seancës. Për kalimin e afatit objektiv është me rëndësi vetëm skadimi i kohës së caktuar dhe sipas dispozitës së përmendur, ky afat kalon 15 ditë pas ditës së mosveprimit. Në rastin konkret paditësi ka qenë i thirrur me rregull për seancën e datës 20.02.2024, përkatësisht ka pasur dijeni për seancën e caktuar dhe nuk ka vepruar brenda afateve

ligjore për të kërkuar kthimin në gjendje të mëparshme, prandaj e ka humbur këtë të drejtë procedurale.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktvendimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 170, 194, 209 paragrafi 1 pika (b), të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.Dh.Sh.II.nr.1327/2024 me datën 11.11.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**